



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 538/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) dega në Vushtri, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) dega në Vushtri.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, KDTP - ja ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë i ka bashkangjitur deklaratat e dhëna nga anëtarët e këtij subjekti politik, me të cilat ka pretenduar se, qëndrojnë pas deklaratës së kryetarit nga radhët e KDTP-së. Më tutje kanë shtuar se, ekzistojnë pa rregullsi dhe mangësi të shumta, si me rastin e shpërprures së votave në mes të listave të partive politike dhe kandidatëve.

Parashtruesi ankesës i ka bashkangjitur tri deklarata të datës 04.11.2013.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga KDTP-ja pretendohet se, janë bërë pa rregullsi dhe mangësi gjatë procesit të votimit.

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, ngase pohimet e lartëcekura nga parashtruesi i ankesës nuk janë objektive, me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nuk është ofruar asnjë dëshmi me të cilën do të vërtetohej një pretendim i tillë ankimorë, shikuar sipas dispozitës së nenit 3.6 pika c) e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it .

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 538/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



Këshillë Juridike:

PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*